

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.

Nr. _____ Prot.

Data 13.02.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje makinerish (ekskavator dhe miniekskavator)”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 43262000-7
Makineri eskavator

VLERA E FONDIT LIMIT: 13.968.817 (trembëdhjet million e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar, nenit 2 germa c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujesjellës Kanalizime Korçë Sh.a., ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim ofertë, sipas Shtojcës 4 ne vlerën 279.376,34 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë presje tridhjetë e katër) Leke (2% të vlerës së përlllogaritur të kontratës).

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

L. Duka

V. Lubonja

L. Kurti

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Objekti i prokurimit të jetë i pasqyruar dhe në ekstraktin e shoqërisë përsa i përket veprimtarisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, dhe 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar .

Kërkesa lidhet ngushte me objektin e kontrates, çka paraqet domosdoshmërinë e objektit të veprimtarisë të OE .

L. Duka

V. Lubonja

L. Kurti

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 ku vlera minimale e xhiros të mos jetë me e vogël se vlera e parashikuar e kontratës. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Baza ligjore (VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ndryshuar neni 43, pika 1 "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare"; neni 43, pika 2/b "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;"

Argumentimi: Ky kriter vjen si rezultat i kërkesave të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi për prokurimet publike dhe ka si qëllim të provohet para AK veprimtaria financiare dhe vazhdueshmëria në fushën e veprimtarisë të OE.

Qëllimi i vendosjes së këtyre kriterëve është që AK të ketë mundësi të krijojë idenë e veprimtarisë ekonomike të OE pjesëmarrës si dhe të mundësisë që ata kanë të përmbushin kontratën.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entitet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" të ndryshuar nën 29 ku përcaktohet se çdo tatimpagues është i detyruar të paraqitë deklaratën e të ardhurave vjetore pranë organeve tatimore brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

L. Duka

V. Lubonja

L. Kurti

3. Kapaciteti teknik dhe profesional:

3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate ose **5.587.527 (pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e njëzet e shtatë) Lekë pa TVSH.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Baza ligjore e detajuar (VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ndryshuar nën 40, pika 4 "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me

sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Ky kriter vjen si rezultat i kërkesave të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi për prokurimet publike dhe ka si qëllim të provohet para AK veprimtaria në objektin e prokurimit, çka rrit besueshmërinë e OE për realizimin e kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

L. Duka

V. Lubonja

L. Kurti

3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog (në gjuhën shqipe) ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

V. Lubonja

3.3 Deklaratë ku merr përsipër dorëzimin me shpenzimet e veta të mjeteve ekskavator me goma dhe miniek ekskavator me zinxhir gome pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë.

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Vendosija e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjeti do të dorëzohet pranë AK i pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së.

V. Lubonja

3.4 Ofertuesi duhet të paraqesë deklarata të ku merr përsipër që në momentin e dorëzimit të mallit duhet të paraqesë të gjithë dokumentacionin ligjor konkretisht për mjetin ekskavator me goma (dokument që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm, pajisur me targa), ndërsa për mjetin miniekskavator me zinxhir gome faturë zhdoganimit.

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, Ligji Nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”. Vendosija e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjeti do të dorëzohet pranë AK i pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së.

V. Lubonja

3.5 Autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojet e mjeteve të ofruara. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet një dokument që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallrave objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

V. Lubonja

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR MAKINERITË (EKSKAVATOR DHE MINIEKSKAVATOR)

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR EKSKAVATOR I RI ME GOMA

Të ketë ruspë përpara e cila të jetë me dhëmbë dhe e hapshme për rrafshim dhe ketë kovë mbrapa.	Po
Viti i prodhimit (min)	2025
Gjatësia (max)	5.7 m
Gjerësia (max)	2.35 m
Thellësia e Gërmimit (min)	4.0 m
Shtrirja horizontale e kovës mbrapa (min)	5.3 m
Të ketë krah teleskopik mbrapa	Po
Kova e pasme me gjëresi	60 cm
Kova para me gjerësi (max)	2.35 m
Lartësia maksimale e shkarkimit	2.74 m
Shpejtësia e udhëtimit (max)	42 km/orë
Numri i Cilindrave	4
Motorrit	Diesel
Kapaciteti i motorrit deri ne	3000 cc
Fuqia motorit (jo me e vogel)	55 kw (74 HP)
Pesha e mjetit (min)	7800 kg
Transmisioni (jo permanent)	4 x 4
Kuti e shpejtesisë me 6 marshe para	Po
Timoni	Hidraulik
Kabina te kete sistem ngrohje dhe ftohje	PO
Sistem stabilizimi te koves gjate ecies	Auto SRS
Standarti i emetimit të gazrave	Euro 5
Kova ekstra e mbrapme me gjerësi	40 cm

SPECIFIKAT MINIEKSAVATOR ME ZINXHIR GOME I RI

Viti i prodhimit (min)	2025
Gjatesia (max)	5 m
Gjeresia (max)	1.8 m
Thellësia e Gërmimit (min)	3 m
Kova me gjeresi	450 mm
Teh (thike) per nivelim te tokes	Po
Lartësia maksimale e shkarkimit	3.3 m
Shpejtësia e udhëtimit (max)	4.5 km/h
Motorrit	diesel
Kapaciteti i motorrit deri në	1700 cc
Fuqia motorit (jo me e vogel)	18.4 kw
Pesha e mjetit (min)	3.5 t
Kabina te kete sistem ngrohje	Po
Rrotullim te plote te kabines	360 grade
Gjeresia e zinxhirit gome	300 mm
Gjatesia e krahut	1300 mm
Standarti i emetimit te gazrave	Euro 5
Mjeti te shoqerohet me karel per transport ose set rampe prej duralumini	Po
Lartesia e karocërise së kamionit që ngarkohet miniekskavatori është 140 cm	Po

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar në bazë të nenit të 36, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendim nr. 633, datë 26.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga Ing. i fushës përcaktuar nga urdhri i ngritur nga Zyrtari i Autorizuar i Autoritetit Kontraktor, në përputhje me ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Afati i lëvrimit do të jetë:

Afati i lëvrimit do të jetë: 45 (dyzetë e pesë) ditë, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës. Mallrat duhet të dorëzohen tek UKRK Sh.A.

V. Lubonja